



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-21210 dt. 09.06 2025

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 19.05.2025, e cila filloi në ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi Bekim Lestrani-kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Malësore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Hamit Kastrati (PDK).

Mungoi: Florentina Elezi-Veliu (VV).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetar i Komunës Rmiz Lladrovci, Petrit Sinani, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Albulena Salihuku, drejtore e Drejtorisë së Financave.

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 18.04.2025;
2. Propozim-vendim për financimin e projektit "HANDIKOS";
3. Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba;
4. Propozim-vendim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 dhe bartjen në vitin 2025;
5. Propozim-vendim për bartjen e fondeve-të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa dhe hodhi në votim rendin e ditës dhe kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e parë të rendit të ditës **1**. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt.18.04.2025, diskutime nuk pati dhe kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e **2**. Propozim-vendim për financimin e projektit “HANDIKOS”, diskutime nuk pati kaloi me vota unanime dhe rekomandohet për Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën **3**. Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Petrit Sinani, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, tha se Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2025, të vendimi 02 nr. 400/03-11633 është bërë një gabim teknik për ndryshim-plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Neni 12 i Rregullores (MAPL) nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës përcakton së “Plotësim-ndryshimi i një akti normativ të Komunës bëhet me akt të njëjtë duke respektuar procedurat ligjore”, andaj plotësim-ndryshimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba të Komunës së Glllogocit nuk mund të bëhet me vendim, por duhet të bëhet rregullore për plotësim-ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba të Komunës së Glllogocit.

Andaj Kuvendi i Komunës së Glllogocit ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në përputhje me kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, duke korrigjuar pjesën hyrëse të aktit ashtu siç është rekomanduar. Pjesa tjetër e dokumentit ka mbetur e pandryshuar, në pajtim të plotë me vlerësimin dhe udhëzimet e dhëna nga MAPL-ja. Diskutime nuk pati kaloi me vota unanime dhe rekomandohet për Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e **4**. Propozim-vendim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 dhe bartjen në vitin 2025. Edhe pika e katër kaloi me vota unanime dhe rekomandohet për Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e **5**. Propozim-vendim për bartjen e fondeve-të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, Po ashtu edhe pika e pestë kaloi me vota unanime dhe rekomandohet për Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën **6**. Të ndryshme, fjala për Arbërin.

Arbër Halilaj, kisha kërkuar nga ju si kryesues nëse ka nevojë edhe Shërbimi i Kuvendit të komunikoni me ASHI-në, sepse është e pa pranueshme që për çështje teknike profesionale, të tyre një asambleist si unë mos me pas qasje që 5-6 muaj në imellin zyrtar po thuajse imelli im e

Arbër Halilaj, kisha kërkuar nga ju si kryesues nëse ka nevojë edhe Shërbimi i Kuvendit të komunikoni me ASHI-në, sepse është e pa pranueshme që për çështje teknike profesionale, të tyre një asambleist si unë mos me pas qasje që 5-6 muaj në imellin zyrtar po thujse imelli im e rrezikon sigurinë kombëtare.

Besoj që ka edhe asambleist të tjerë që nuk u funksionon imelli zyrtar, por arsyetimi im është se është infektuar me virus por janë jo transparent, nuk komunikojnë dhe nuk japin zgjidhje thjesht jam i shkëputur nga komunikimi zyrtar.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Arber a i ke bërë shkresë Ukë Krasniqit apo ASHI-së sepse kjo nuk është qështjje e jona por është qështjje e Ukës, ai duhet të jepë përgjigjeje, sepse ai duhet të komunikojë me ASHI-në për me e zgjidhe këtë probleme që keni me emaili, ose le të merr Beka përgjesinë me i shkrujtë një email që Arber Halilajt nuk po i funksionon emaili zyrtar a na jepni një përgjigjeje pse nuk po funksionon, sigurisht kemi të gjithë probleme por të kësaj natyrë kaqë të gjatë nuk mundet me pas askush, Ukës ju drejtoheni jo tjetër kujtë.

Hamit Haxhiu, në qoftëse i shkruani imell na përfshini edhe ne së disa asamblesist kemi probleme me email zyrtar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, deklaroi së do të merrem me këtë çështje, por edhe një gjë duhet të keni parasysh që, emaili zyrtar nëse nuk hapet të pëkten një herë brenda 30 dite, aktivizohen kodet e sigurisë, pastaj duhet me bërë kërkesë me ndërrua pasvordin, por megjithat si Kuvend kemi me i'a bërë një kërkesë Ukës edhe ASHI-së, sepse Uka pretendon që ASHI-ja, i ka marrë kompetencat dirkte, por ne si Komunë duhet me bërë zgjidhje.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne e kemi marrë një përgjigje po thujse të njëjt si për Rregulloren për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Edhe për pronën që e kemi dhënë për panela diellor TDI, MPL-ja, kanë thënë më ndryshu dhe me largu prej listës paraprake për me mundur me e dhënë në shfrytëzim, në qoftëse nuk kemi përgjigje deri në mbledhjen e radhës, duhet me e sjellë edhe një herë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, tha se diskutime tjera nuk pati.


Mbledhja përfundoi në ora 10:20.

Procesmbajtësja



Fakete Hoti

Lekturoi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani